



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DREJTORIA E PROKURIMEVE



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik “B-VAAL ENGINEERING” sh.p.k, me NIPT L72023002P, me seli në Adresën: Tirane, Paskuqan, Lagjja Paskuqan 1, rruga Demokracia, ndertesa nr.1, pranë Ahmati Petrol.

Lloji i procedurës se prokurimit: “Kërkesë për Propozim”

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: Mbikqyrja e punimeve të ndërtimeve dhe rikonstruksioneve të rrjetit të Ujësjiellës Kanalizimeve për UKT sh.a. (Faza IV)”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-83538-08-22-2018

Numri i referencës së procedurës/lotit 6 REF-83554-08-22-2018

Fondi limit në total: 4.969.931 (Katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH, të ndarë në lote si më poshtë vijon:

Loti i gjashtë: Mbikqyrja e punimeve për objektin: “**Blerje sistem kamerash**”, me fond limit **218.864** (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë katër) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Për Lotin e gjashtë afati: Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërrmarjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve (afati 3 muaj).

Burimi i financimit: Të ardhurat e SH.A Ujësjiellës-Kanalizime, Tiranë.

Data e zhvillimit të tenderit është: 10.09.2018 Ora: 09:00

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 34 datë 27.08.2018

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "REAN 95" sh.p.k NIPT-i J61827043V

Vlera: 135.700 (njëqind e tredhjetë e pesë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH

2. Operatori ekonomik "B-VAAL ENGINEERING" sh.p.k NIPT-i L72023002P

Vlera: 201.355 (dyqind e një mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Të skualifikuar:

1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "**REAN 95**" SH.P.K

Çmimi total i ofertës: 135.700 (njëqind e tredhjetë e pesë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH dhe me vlerë 195.227 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë vijon:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjate shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur elektronikisht nga Operatori Ekonomik "REAN 95" SH.P.K konstatoi se, Operatori Ekonomik "REAN 95" SH.P.K. ka dorëzuar Formularin e ofertës ekonomike në të cilën dallohen mospërputhje në vlerën e ofruar, pasi në pjesën deklarative të ofertës është ofruar vlera 135.700 lekë pa TVSH dhe vlera 162.840 lekë me TVSH, ndërsa në tabelën ku pasyrohen çmimet për njësi, vlerat në total janë 195.227 pa TVSH dhe 234.272 me TVSH. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se në Formularin e ofertës, vlera e ofruar në tabelën e çmimeve për njësi ka mospërputhje me vlerën e ofruar në pjesën deklarative të ofertës ekonomike me një diferencë në masën 27%, të Fondit limit pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson të theksoj se me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 66 të VKM-së të sipërcituar, në ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik, nuk lejohet të kryhet asnjë modifikim tjetër. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik, “B-VAAL ENGINEERING” SH.P.K me NIPT L72023002P, me administrator Z.Valter Begaj, me vlerë të ofertës: 201.355 (dyqind e një mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, **se është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga “5 Maji” pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi. Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 12.09.2018

Ankesa: Nuk ka patur.

